

ARTET FIGURATIVE SHQIPTARE

PIKTURA

Artet Figurative Shqiptare

RIKTURA

SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»
TIRANË, 1978



ENVER HOXHA

PIKTURA SHQIPTARE E KOHËS SONË

Albumi mbi pikturën shqiptare është i pari nga një varg syresh, kushtuar arteve figurative dhe të aplikuara të Shqipërisë, që Shtëpia Botuese «8 Nëntori» do të nxjerrë. Ky përfshin veprat e pikturës shqiptare, të ndara sipas autorëve, duke nisur nga fundi i shekullit XIX, kur fillon arti shqiptar i kohës së re, dhe deri në veprat e pikturës së sotme të realizmit socialist, të cilat në përshtatje me vlerën, rëndësinë dhe prodhimin e tyre të shumtë zenë vendin më të madh.

Në kushtet shoqërore e politike të socialistët në Shqipëri, nën kujdesin e vazhdueshëm dhe me orientimet e Partisë janë zhvilluar dhe kanë marrë hov të gjitha llojet e gjinjës e letërsisë e të arteve. Ato përbëjnë një art realist e revolucionar që synon gjithnjë e më shumë të jetë shprehës i aspiratave shoqërore dhe i idealeve estetike të masave të popullit dhe t'u përkasë atyre, art me tendenciozitet të hapur ideologjik proletar që milion për komunizmin. Në këtë rrugë është zhvilluar edhe piktura, sipas specifikës së saj, duke arritur krijimin e veprave me vlera të shquara artistike.

Piktura shqiptare e realizmit socialist u zhvillua mbi një traditë relativistë të re dhe jo aq të shumtë, por realiste e me tipare kombëtare e popullore.

Trashëgimi i pikturës në Shqipëri është shumë i lashtë, duke nisur me pikturat e shpellave të mijëvjeçarit të tretë para erës sonë, me qera-

PIKTURA

mikën e piktuuar, të quajtur nga shkencëtarët e stilit «devollit» të fiseve ilire, të periudhës së hershme të bronxit, më vonë me mozaikët e stilit romak dhe mozaikët e pasur paleokristianë të mesjetës së hershme e deri në pikturen me vlera të larta artistike të stilit bizantin para pushtimit turk dhe ringjalljen e saj më vonë me elementë realistë.

Por pushtimet e huaja, sidomos sundimi pesëqindjeçar otoman, kundër të cilave populli shqiptar ka luftuar e ka ngritur krye me trimëri e heroizëm, nuk kanë lejuar një zhvillim të barabartë dhe të pandërprerë të kulturës dhe artit. Që në fillim të shekullit XVIII (gjatë më shumë se një shekulli e gjysëm) e deri në mesin e shekullit XIX, vetëm arkitektura origjinale popullore, artizanati i pasur dhe arti i larmishëm dekorativ fshatar plotësuan në njëfarë mënyre, me zhvillimin e tyre të madh, mungesën e një arti figurativ të kultivuar.

Lëvizja e madhe e Rilindjes Kombëtare për liri e pavarësi, lëvizje kjo kundër pushtimit turk, duke luftuar me pushkë, luftoi edhe për shkollën shqipe e krijoi letërsinë e re shqiptare, kulturën kombëtare dhe zhvilloi deri diku edhe artin, sidomos pikturen.

Veprat e para të pikturesh së Rilindjes Kombëtare u krijuan më 1883 nga piktorë ikonografë, piktorë që kishin mësuar në shkollat e larta të Evropës Perëndimore si edhe piktorë autodidaktë, por që, të gjithë, në një mënyrë apo në një tjetër, kishin lidhje me artin populor. Piktura e Rilindjes Kombëtare u shkëput, që në fillim, nga përbajtja fetare e artit mesjetar, ashtu sikundër lëvizja për çlirimin kombëtar u zhvillua nën parullën e bashkimit të shqiptarëve për idealin e kombit dhe të lirisë duke lënë kështu mënjanaë dallimet fetare. Kjo pikture ka një përbajtje patriotike, me tematikë historike dhe shpesh etnografike popullore.

Nuk ka asnjë piktor apo skulptor shqiptar që të mos ketë trajtuar të paktën një herë figurën e Gjergji Kastriotit Skënderbeut, simbol i lavdisë dhe i bashkimit të kombit shqiptar në luftë kundër pushtuesve të huaj.

Piktori autodidakt e patriot Spiro Xega e ka piktuuar në tetë variante portretin e tij, ndërsa tabloja më e shqar e piktorit është kompozimi ngajeta e komitëve «Çeta e Shahin Matrakut», të gjitha të trajtuar me një naivitet të sinqertë të ngashëm me realizmin e arit popullor dhe të përshkruara nga një frysë romantike.

Padyshim piktori më i shqar i Rilindjes Kombëtare është Kolë Idromenoja. Kompozimet e tij, si «Dasma shkodrane», portretet e shumta dhe peizazhet, dallohen nga një pasqyrim realist i personazheve dhe tipave, nga një përshkrim i përpiktë i zakoneve, kostumeve dhe ambienteve karakteristike kombëtare. Linja e tij është e mprehtë, drita e butë dhe ngjyrat lokale, më fort të embla. Shpesh ai piktuaron me një realizëm të drejtë-drejtë, kurse herë të tjera e modelon formën dhe i skalit detalet si objekte të bukuria të artizanatit popullor. Disa portrete janë të thelluar në psikologji dhe në përgjithësimin shoqëror, ku del edhe ndonjë problem i kohës, duke piktuuar edhe njerëz të popullit të thjeshtë. «Portreti i motrës së tij Tone» është një nga veprat më të bukuria të pikturës shqiptare të asaj kohe. Ai përfytyron një grua të shtresave të mesme të qytetit të Shkodrës, të fundit të shekullit të kaluar, të veshur me kostumin e saj karakteristik. E mbështjellë në maramanë e bardhë e transparente, e rrëthuar nga veshjet e qëndisura e zbukurimet në filigranë të materializuara aq bukur, grua e re, me fytyrën e rrumbullakët dhe duart punëtore, vështron anash me drojtje dhe përpiqet të mbulojë fytyrën: jeta e saj është e ndrydhur si në shtëpi ashtu edhe në rrugë, por piktura ka shkëlqimin e endejeve në mëndafsh dhe të zbukurimeve të argjendta.

Ndonëse nuk i arrin vlerat e mësuesit të tij, tablotë e Simon Rrotës të tëra së bashku, jepin një pamje të larmishme, aty-këtu me një kolorit të egër, të punës, të rrugëve, të zakoneve të Shkodrës dhe rrëtheve të saj.

Portreti, në Rilindjen Kombëtare, gjen shumë porositës të cilët kërkojnë, në këtë mënyrë, të pohojnë personalitetin e tyre. «Portreti i Doktorit» nga

Ndoc Martini, realist, me kontraste dritë e hijesh dhe penelata të ngjeshura, është shprehës i shqetësimeve të intelektualit të kohës.

Në Shqipërinë e shpallur të pavarur më 1912 veprat artistike që dallohen për diçka të re, ndonëse prapëseprapë të pakta, fillojnë të duken rrëth dhjetë vjet më vonë. Ndërsa në skulpturë zhvillohen idetë patriotike të Rilindjes Kombëtare, me një realizëm të frysmauar, përfiqësuar nga vepra e Odhise Paskalit, në pikturë zhvillimin më të madh e merr peizazhi. Piktura, duke qenë përgjithësisht realiste fiton më shumë shprehje në konceptimin estetik të veprës të disa autorëve me personalitet të ndryshëm.

Nëpërmjet një ndjenje lirike delikate, piktura me dritë e ngjyra të çelura e Vangjush Mios është e gëzuar para rrugëve dhe shesheve të qyteteve e fshatrave me shtëpitë karakteristike të stilit populor, është e gëzuar para fushave, liqeneve e maleve mavi, nëpër të cilët venë e vinë, punojnë, takohen njerëzit e thjeshtë të popullit. Ai e pikturon natyrën në të katër stinët e motit, por sidomos e tërheq vjeshta shqiptare me të verdhat e saj të kuqërrimta. Në këtë mënyrë e shpreh piktori dashurinë e tij për Atdheun në peizazhet «Rrugë në Korçë», «Vjeshtë në Drenovë» etj.

Zef Kolombi është piktor kërkues e me mendim. Portretet e tij janë të thelluara në psikologji dhe zbulojnë karaktere të forta. Shpesh nga peizazhet e tij, si «Të korrat», të konstruktua me vizatim e ngjyra të ngjeshura, buron një ndjenjë heshtjeje melankolike, pasqyrë e gjendjes së rëndë shpirtërore të vendit dhe të krizës në vitet e regjimit të mbretit dhe të fashizmit. Në disa portrete dhe sidomos në natyrat e qeta, Zef Kolombi punon me teknikën e plen-erit¹⁾, por duke i qëndruar besnik një vizatimi konstruktiv të pasuruar nga nuancat e shumta të ngjyrave në dritën e përthyer.

1) Nga frëngjishtja plein-air — në ajër, përashta, në natyrë të hapur.

Ndërsa peizazhet e trishtuara të Shefqet Agaliiut, apo piktura e ndonjë skene të jetës së mjerë pasqyrojnë gjendjen e vendit, në disa portrete si «Plaku» i Andrea Kushit, bëhet me realizëm një farë përgjithësimi i shtresave të varfëra të shoqërisë së kohës, duke ngjallur ndjenjën e dhembshurisë për to.

Në krijimet e disa piktorëve që e fillojnë veprimitarinë e tyre krijuese në fund të viteve 30-të, përsfytyrimi i peizazheve apo skenave ngajeta e vendit bëhen me një vizatim ekspresiv e ngjyra intensive dhe me një interes pak estetizant për kostumet popullorë, kështjellat e lagjet e vjetra me kaldrëme, për enët origjinale prej balte a druri.

Përballë arit zyrtar pompoz ose të mefshët të fashizmit e që i largohej problemeve të realitetit, vizatimet, skicat, gravurat e shtypit antifashist të Luftës Nacionallirintare të udhëhequr nga Partia Komuniste Shqiptare, me frymë luftarake e militante, pavarësisht nga kufizimet teknike e artistike, që justifikohen për ato kushte, shënojnë fillimin e arit të ri të realizmit socialist.

Asnjëherë kultura dhe arti nuk kishin pasur në Shqipëri kushte më të favorshme dhe ato mundësi që erdhën gjithnjë duke u shtuar sesa pas vendosjes së pushtetit popullor dhe me vazhdimin e revolucionit socialist. Epat e ndryshme të evolucionit të pikturës janë të lidhura me zhvillimin e ndërtimit socialist. Ndryshuan përbajtja dhe karakteri i artit. Tashmë, si të thuash, «porositësi» i tij është populli, masat e gjera. Kultura, letërsia, arti, janë të destinuara të luajnë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në jetën shoqërore, në pasurimin dhe formimin shpirtëror të një njeriu të ri. Këndej rrjedhin edhe orientimet dhe detyrat që Partia e Punës së Shqipërisë dhe udhëheqësi i saj, shoku Enver Hoxha, shtrojnë vazhdimisht për artistët. «Duhet të inkurajohet dhe të ndihmohet zhvillimi i literaturës sonë, i teatrit, i pikturës, i folklorit, — tha shoku Enver Hoxha në mesazhin drejtuar popullit me rastin e 1 Majit të vitit 1947. — Zhvillimi

i këtyre të bëhet në baza të drejta, të jetë i lidhur *ngushtë* me realitetin shoqëror, ekonomik dhe politik të vendit tonë, të jetë i lidhur *ngushtë* me *popullin* dhe të pasqyrojë *luftën e tij*, përpjekjet, aspiratat, perspektivën e ndritur të rrugës ku po ecën *populli ynë*.

Kërkeseve shoqërore u parapriu skulptura, një sërë statujash dhe bus-tesh të heronjve të Luftës Nacionalçlirimtare dhe të njerëzve të tjerë të shquar që u ngritën në qytetet e fshatrat e Shqipërisë. Nevoja e një pikture që t'i përgjigjet pasqyrimit të gjerë artistik të veprimitarës dhe gjithë jetës së popullit, ngjarjeve të mëdha të së kaluarës dhe të së sotmes, kërkonte që shpejt të merrnin zhvillim gjini të mëdha si kompozimi. Por përmbytja e rëndësishme aktuale e shoqërore dhe fryma optimiste ndihet edhe në portret, peizazh e deri te natyra e qetë.

Piktoret që e kishin formuar përpëra personalitetin e tyre krijues angazhohen me një tematikë të re, duke kërkuar një shprehje më të vërtetë e më dinamike. Ndërsa Zef Kolombi e mbyll jetën me veprën e tij të fundit «Masakrat» e frymëzuar nga Lufta Nacionalçlirimtare dhe Vangjush Mio kap në peizazhet e tij elementet e reja të jetës socialist, Abdurrahim Buza për herë të parë eksposon veprat e veta dhe fillon një veprimitari krijuese origjinale me tablo si «Punë vullnetare në Kombinatin e Tekstileve «Stalin», përshtypje e drejtpërdrejtë me penelata të gjallë e të ngrohta, nga veprimitaria e masave në vitet e para të ndërtimit socialist.

Një radhë piktoresh të rinj zgjerojnë dhe afirmojnë veprimitarinë e tyre krijuese pikërisht në vitet e para pas vendosjes së pushtetit populor. Ata përgjithësisht janë realistë dhe të lidhur me traditat dhe artin populor.

Përbajtja e pikturës së këtyre viteve buron nga aktualiteti i epopesë së Luftës Nacionalçlirimtare që është ende fare e afërt, nga vrulli i punës ndërtimitare të masave të popullit si edhe disa herë nga e kaluara historike. Kompozimet e para janë përgjithësisht përshkruese, pikturna kërkon

një pasqyrim të drejtpërdrejtë të realitetit dhe veçanërisht individual të modelit, personazhit, ambientit.

Për kërkimin e një vizatimi të saktë, dhe të materializimit të objekteve shquhet Nexhmedin Zajmi me kompozimet e para, si «Tregim nga Lufta Nacionalçlirimtare», evokim i një momenti të përditshëm, pritja e ngrënës së partizanëve në shtëpinë e një fshatari gjatë atyre viteve të stuhishme, ose në portrete të thelluara në tip dhe në psikologji, si «Nëna labe». Disa autorë të tjere pasqyrojnë momente nga puna dhe jetës në minierë, kantiere e fushat e kolektivizuara, që klasa punëtore dhe fshatarësia tashmë i ka të sajat, në tablo të përshkruara me një vërtetësi objektive e disa herë me një dritë të ngrënës.

Por piktura, sidomos me disa tablo që krijohen më vonë, fillon të kërkojë kufizimet e fazës së parë. Kompozimi «Mëngjesi i 17 Nëntorit» (ose «Çlirimi i Tiranës») i Bukurosh Sejdinit, që përfytyron, në një atmosferë muzgu mëngjesor, mbi gërmadhat e betejës që sapo ka mbaruar, ndërsa prapa malit po lind dielli dhe fryni një puh i lehtë, një partizan në mes të një grupi njerëzish të popullit që ngre lart një fëmijë, merr një kuptim përgithshëm historik.

Zhvillimi i vrullshëm i ndërtimit socialist në fund të viteve 50 favorizon më shumë artin dhe piktura shënon përparime të dukshme. Këto janë vitet kur, nën udhëheqjen e Partisë së Punës, ngritet industria, fshati kolektivizohet pothuaj se në të gjithë vendin, klasa punëtore është rritur e forcuar, po konsolidohen marrëdhënie të reja shoqërore, me pak fjalë ndërtohet baza ekonomike e socializmit dhe vihet re një rritje e ndërgjegjes së njeriut të ri të punës.

Rëndësi të veçantë ka lufta e vendosur e Partisë së Punës së Shqipërisë për të vazduhar me vendosmëri rrugën e socializmit, duke mbrojtur marksizëm-leninizmin përballë ideologjisë borgjeze dhe rrezikut të ri që u shfaq, revisionizmit modern. Ndërsa vendi angazhohet të fillojë ndër-

timin e plotë të shoqërisë socialiste, në kushtet e rrethimit dhe blokadave imperialiste e revizioniste, Shqipëria i kapërciu me guxim vështirësitë e shkaktuara nga armiqëtë dhe qau me vrull përpjaka. Jo vetëm ekonomia, por edhe kultura e arti arritën suksese, duke e bërë më aktuale përbajtjen e tyre, duke thelluar partishmërinë proletare dhe duke u mbështetur më mirë në truallin kombëtar. Në artin shqiptar u afirmua metoda e realizmit socialist.

Piktura, sidomos pas vitit 1960, pasqyron me vërtetësi artistike realitetin dhe idetë aktuale, veprimtarinë e klasës punëtore dhe të gjithë masave në ndërtimin e veprave të mëdha të socializmit, betejat e tyre epike në të kaluarën dhe sot për lirinë, përparimin dhe idealet komuniste. Kompozimi është më i zhđervjellët. Në veprën e piktorëve të ndryshëm vihet re një evolucion drejt një vizatimi më plastik dhe një koloriti më të kthjellët e të pastër. Kontigjenti i tyre rritet me piktorë të rinj, shumë prej të cilëve kanë mësuar në shkollat e vendit.

Kompozimet historike të Guri Madhit, nga një trajtim me efekte drite e hijesh të penelit në veprat e tij të para, si «Bajram Curri në shpellën e Dragobisë», evokim i luftëtarit të madh kundër robërisë e tiranisë, kalojnë në një pikturë me drita dhe ngjyra në lëvizje të plen-erit, si në tablonë «Formimi i Shtabit të Përgjithshëm».

Fatmir Haxhiu e nis veprimtarinë e tij me kompozime me temën e heroizmit të popullit shqiptar në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, të cilës do t'i kushtohet kryesisht. Tabloja e tij «Skroçë 44» me një zgjedhje pothuajse klasike, rikrijon atmosferën e stuhishme në çastin kur nis marshimi i Brigadës së Parë në Veri, ngjarje që do të mbetet në histori.

Piktura e Agim Fajës ndërtohet në sipërfaqe të gjera ngjyrash dekorative si në panonë «Verë e vitit 1965» të frysmezuar nga mobilizimi i masave të popullit për të mposhtur thatësirën.

Piktori Zef Shoshi, që në fillim, ia kushton krijimet e tij jetës së

fshatit, të krahinave të Veriut. Në kompozime ai trajton temën e punës në fshatin kooperativist. Piktura e tij ka ngjyra të çelura, dritë të kthjetë e vizatim të hollë dhe të sjell ndër mend, shpesh, bukurinë e nuançave të artit populor të krahinës së Zadrimës. Me një shije të tillë, në sipërfaqe të gjera dhe e mbajtur në dy a tre tone, është «Vajza fshatare» me veshje popullore, ku zbulohet psikologjia e qiltër dhe e gëzuar e kooperativistes së re.

Personazhi kryesor i portretit është tashti punëtori pararojë, kooperativistja e dalluar, luftëtari trim dhe militanti. Piktura e Foto Stamos, autor i një radhë portretesh e peizazhesh, fiton ngjyra më të çelura, të hedhura në penelata të shpejta si në «Partizanin» e thjeshtë e trimëror.

Marshimi i revolucionit në rrugën e socializmit, nuk krijon vetëm kushte e mundësi gjithnjë e më të mëdha për rritjen e prodhimit artistik, por shtron para artit edhe detyra të reja. Thelliimi i revolucionit ideologjik është luftë klase për afirmimin e ideologjisë proletare marksiste-leniniste kundër ideologjisë borgjeze e revisioniste. Ky revolucion kërkon që edhe arti të rrisë rolin e tij për edukimin komunist.

Që nga fundi i vitit 1965 fillojnë, nën udhëheqjen e Partisë, një radhë lëvizjesh e aksionesh revolucionare kundër burokratizmit, kundër mbeturinave të besimeve fetare, për emancipimin e plotë të gruas, për kalitjen e rinisë etj. Këto aksione që përfshijnë masat e popullit në të gjitha aspektet e jetës kanë për qëllim të rrënjosin koncepte socialiste proletare në ndërgjegjen e njerëzve dhe në të njëjtën kohë t'i presin rrugën degjenerimit revisionist borgjez të vendit socialist. Të gjitha këto pasqyrohen në brendinë e artit dhe ndikojnë në shprehjen e tij.

Nga viti 1968 veprimtaria artistike rritet shumë, ngrihen një radhë monumentesh komplekse, hapen shumë ekspozita të rëndësishme, zhvillohen shumë lloje e gjini të arteve figurative, përvëç skulpturës e pikturës edhe grafika e lirë, skenografia dhe gjini të tjera të arteve të aplikuara.

Përbajtja e piktureve bëhet shumë aktuale. Realiteti i ditës dhe e kaluara interpretohen me një tendenciozitet të thelluar proletar në tablo ku klasa punëtore, fshatarësia, masat e popullit janë heroi kryesor. Tablotë i trajtonë në mënyrë origjinalë dhe shpesh me dramaticitet subjektet e tyre. Për t'iu përgjigjur madhështisë së ndërtimit socialist, të veprimitarisë aktuale dhe të kaluar të masave, krijojen tablo të mëdha, bile edhe shumë-pjesëshe. Në kompozime e portrete spikasin tipa e karaktere të ndryshme. Zgjidhjet e tyre kompozicionale janë dinamike, trajtimi plastik është më i plotë dhe më ekspresiv, koloriti më i larmishëm, duke ruajtur personalitetin e çdo autorit.

Piktura pasqyron aspektet e reja të ndërtimit socialist. Duke evoluar në mënyrën e tij realiste të të piktuarit, Nexhmedin Zajmi përgjithësos klasën punëtore në ndërtimin e veprave të mëdha me tablonë e tij «Diga e Drinit», ku përfytyron tre minatorë tipikë me veçoritë e malësorëve që kanë zbritur në kantieret. Veprimitaria ndërtimtare e klasës punëtore përbën subjektin e një radhe tablosh me vizatime dinamike e pasuri ngjyrash shprehëse të Danish Jukniut, i cili, në kompozimin «Në kantierin e Dritës», jep madhështinë e punës në ndërtimin e një hidrocentrali vigan.

Revolucionarizimi i gjithanshëm i jetës është subjekti i shumë tablove të përskuara nga fryma e entuziazmit revolucionar, si «Një për të gjithë e të gjithë për një» i Minella Saros, ku me realizëm die emociion të brendshëm tregohet për solidaritetin e popullit të të gjitha krahinave, që ka shkuar për të ndihmuar në rindërtimin e fshatrave të dëmtuara nga tërmeti etj.

Në momente të reja dhe me dramaticitet të theksuar trajtohet edhe Lufta Nacionalçlirimtare. Heroizmi dhe vetëmohimi i partizanëve të pasqyruar prej saj i bëjnë jehonë gatishmërisë së popullit për të mbrojtur atdheun socialist nga çdo rrrezik. Kjo fryshtëzon piktorin Sali Shijaku për krijimin e tablosë «Vojo Kushit», ku me pak ngjira, në kontraste të forta,

zi, kuq, bardhë, ngrihet lart vigane figura historike, që përmes flakëve e tymrave që kanë zënë qiellin hedh një bombë mbi tankun armik. Në këtë veprim e atmosferë, me gjoksin zhveshur dhe këmishën e kuqe që i valëvitet si flamur, ai merr kuptimin përgjithësues të heroizmit të popullit shqiptar në luftë kundër pushtuesve fashistë. Në këtë tablo kristalizohen disa tipare të mënyrës së lirshme dhe me një kolorit të thellë ekspresiv të këtij piktori që duket në gjithë veprat e tij të mëvonshme. Po kështu dramaticitet, shprehje vendosmërie dhe frymë romantike ka në tablonë me ngjyra të pjekura dhe karaktere të thelluara «Urdhër nga Shtabi» të Hasan Nallbanit dhe në veprat e tjera.

Fryma e gatishmërisë dhe e vigjilencës përballet rrezikut të agresionit imperialist-revisionist, që përshtkon gjithë vendin, e nxjerr në plan të parë temën e mbrojtjes së atdheut socialist. Në triptikun «Ushtarët e Revolucionit» përmes formash të rrepta dhe ngjyrash të pastra që karakterizojnë mënyrën e pikturimit të Pandi Meles, përfytyrohet në tri momente e në kurse monumentale lidhja me popullin, preqitja e repte ushtarakë dhe puna e vetëdijshme për ngritjen politike e ideologjike të ushtrisë popullore.

Epika popullore pasqyrohet në shumë tablo me tema historike. Një tension të veçantë përshtkon çdo ind të tablosë «Vrana Konti në Krujë» e frymëzuar nga qëndresa e lavdishme e popullit shqiptar përballet dynjave otomane në shekullin XV, vepër e piktorit Skënder Kamberi, pikatura e të cilit shquhet për kontrastet e dritave e të ngjyrave dhe në përgjithësi për ekspresivitetin e saj.

Edhe peizazhi kap elemente të reja të cilat i ka sjellë vetë realiteti socialist dhe shpreh një qëndrim të ri pohues optimist ndaj natyrës në përgjithësi. Të pastra janë ngjyrat dhe planet në peizazhin me motivin e elektricitetit që shkon në çdo skaj, në peizazhin e gjerë «Dritë në Malësi» të Agim Zajmit. Fryma e revolucionarizmit përshtkon shtëpitë e ngje-

shura një mbi një që shkëlqejnë nga dielli, ndërsa përmes tyre kalojnë kamiona me flamuj të kuq në peizazhin «Mijëra në aksione» të Qiriako Menikos. Begatia e gjelbërimit, e luleve, e përparseve të bardha të fëmijëve dhe lashtësia e trungut të ashpër të ullirit dhe mureve mbi shkëmb kryqëzohet në peizazhin «Në kështjellën e Krujës» të Dh. Trebickës.

Arti shqiptar përgjithësia është dñe pikatura në veçanti tashmë mbështeten fort në eksperiencën e vet, në traditën e vjetër dhe të re të fituar në periudhën e socializmit, dhe në të njëjtën kohë kërkojnë shprehje të thellë emocionale që i përgjigjet me një formë sa më të plotë patosit revolucionar, idealeve komuniste që synojnë të mishërojnë. Originaliteti i pikurës shqiptare të realizmit socialist buron nga vetë realiteti i ri socialist në zhvillimin e tij revolucionar, që pasqyron. «Të gjitha këto, si dhe mbështetja fort në truallin kombëtar në krijimtarinë e trashëgiminë kulturore përparimtare të popullit tonë i jepin letërsisë dhe artit socialist atë originalitet dhe atë novatorizëm që e dailojnë nga të tjerët, jo vetëm si krijimtari e një populli dhe një kombi të caktuar, por edhe për tiparet që fiton kjo krijimtari përmes kushteve të luftës kundër imperializmit e revisionizmit modern dhe për revolucionarizmin e gjithë jetës së vendit», — tha shoku Enver Hoxha në Kongresin VI të PPSH në vitin 1971.

Piktura, ashtu sikundër gjithë arti dhe letërsia shqiptare e realizmit socialist, kanë qenë gjithnjë realiste, të kuptueshme e komunikuese për popullin, me ide dhe aspak banale. Ato janë forcuar në luftë kundër deformacioneve dhe degjenerimit të artit borgjez e revisionist.

Plenumi IV i KQ të PPSH i vitit 1973 i kritikoi ashpër disa ndikime të huaja moderniste, si të dëmshme dhe të rrezikshme për artin proletar dhe socializmin. Lufta kundër koncepteve artistike morale dekadente forcoi në radhë të parë partishmërinë komuniste të artit, kundër të cilët hidhen ideologët borgjezë e revisionistë, forcoi frymën e tij militante dhe karakterin kombëtar. Pas Plenumit IV të KQ të PPSH, në pikturë u krijuan

vepra me vlerë përgjithësuesë shoqërore e historike. Ato synojnë një përbajtje madhore dhe shumë vepra, sidomos kompozime në përpjesshme të mëdha, pasqyrojnë gjërësiht realitetin dhe kanë karakter monumental, vizatim të thelluar plastik, pasuri koloristike e ekspresivitet. Ato i përgjigjen, në unitet ideor estetik, vetë realitetit madhështor, transformimeve të mëdha që kanë ngjarë në jetën e vendit, luftës me rëndësi historike që bën populli shqiptar i udhëhequr nga Partia e tij e Punës për ndërtimin e socializmit dhe përmbrojtjen e marksizëm-léninizmit.

Tabloja historike nuk kufizohet vetëm me ngjarjet e së kaluarës, por edhe me ngjarje të shquara të ditëve tona. Një frysë romantike e tragjike pëershkon tablonë «Shote Galica» të Ismail Lulanit. Silueta e patriotës heroike ngrihet e madhërishtë para sfondit të përfshakur të qellit dhe flamurit kuq e zi, me një fytyrë plot patos të zjarritë, e dallohet mbi fatosat e çetës që ajo udhëheq me trimëri të rrallë. Figurën e rrezeve që përhapen nga qendra në të gjitha anët sugeron tabloja «U themelua Partia» e Shaban Hysës. Trajtimi realist i momentit kur përfaqësuesit e grupeve komuniste, më 8 Nentor 1941, me shokun Enver Hoxha në ballë, po bethohen në këmbë, lidhet në të njëjtën kohë me kuptimin simbolik që merr drita e llambës së vogël në mes, e vendosur mbi tryezën e mbuluar me cohë të kuqe, dritë që, e rrëthuar nga grushtet e shtrënguar dhe fytyrat e tendosura, duket sikur do të shpërthejë. «Ndarja e tapive» e G. Madhit zhvillohet si një valle e fshatarëve që gëzojnë marjen e tokës. Në mes tyre është edhe shoku Enver Hoxha. Vendosmëri dhe frysë luftarakë ndihet në qëndrimin e njerëzve të ndryshëm të popullit të mbledhur në sheshin e kryeqytetit, në tablonë me ngjyra të thella «Denoncimi i traktatit të Varshavës» të Vilson Kiliçës, një nga veprat me temën e luftës së popullit shqiptar kundër revizionizmit modern dhe qëdo imperializmi.

Njerëzit e rinj të punës, punëtorët, fshatarët, janë heronjtë e tablove të frysëzuar nga veprimtaria e tyre plot gjallëri. Tabloja «Zëri i masës»

e Sali Shijakut përfytyron një ambient plot dritë e ngjyra të gjëzuara, si ato të endjeve popullore, ku punëtorët, të skalitur secili në tiparet individuale, me vëmendje e dashuri të veçantë, së bashku me piktorin, diskutojnë para një vepre të re artistike. Qëndrimet, gjestet, janë të gjalla e psikologjia e zguar, dhe qdo gjë është e trajtuar me plasticitet të thelluar. Është ideja e kulturës dhe artit që i përket klasës punëtore, popullit. Të shëndetshme, me gjeste harmonike, ecin përmes grurit të gjelbër valëvítës kooperativistet e reja, duke përhapur plehun e bardhë që e merr era, në tablonë «Buka e duarve tonë» të Skënder Kamberit, për të treguar me një pikturë me ngjyra të ngjesitura materiale punën e palodhur të fshatarit të ri që zoteron shkencën, teknikën moderne, dhe mbush fushat e kodrat deri në fund të horizontit me drithë e begati. Në tablonë me ngjyra të ngrohta të tokës «Kthim nga puna» të Andon Lakuriqit, është portreti i familjes së re të fshatarit kooperativist me psikologjinë e njerëzve të kënaqur nga puna e frytshme kolektive që kryejnë. Poezia e punës bukuria e jetës së njerëzve të thjeshtë në Shqipërinë e sotme, zbulohet përmes figurave të hedhura të punëtorëve dhe ngjyrave të çelura në tablonë «Drejt lartësive» të Shpëtim Arapit, nëpërmjet figurës së fuqishme të bariut në gjelberimin e thellë të maleve, në tablonë «Barinjtë» të Bujar Asllanit etj.

Disa herë piktura ka një kuptim përgjithshëm pothuajse simbolik. Me një solemnitet të thjeshtë janë vendosur lojtarët e fyejeve para majave të larta me déborë në tablonë me kolorit të kaltërt «Barinjtë në bjeshkë» të D. Jukniut. Originale është zgjidhja kompozicionale, në friza ku lëvizin siluetat e kthjellta të malësorëve dhe malësoreve, në tablonë «Lojnat popullore» të Abdurrahim Buzës, si një sintezë ritmike e trashëgimit të kulturës kombëtare.

Figurat e njerëzve në portretet janë karaktere të fuqishme punëtorësh e luftëtarësh të thjeshtë në qëndrimet, të lartë në vetitë e tyre morale. E pikturuar me një vizatim ekspresiv dhe ngjyra të përmbytura, po shprehë-

se, «Nëna e dëshmorit» e Rakip Shabanit është krenare dhe e pamposhtur. «Mjelësja» e Sotir Capos shkëlqen në mes të bardhësisë higjenike të stallave, duke dalë në pah ftyra e bukur dhe e zgjuar e gruas punëtore.


Natyra e transformuar apo e përvjetshme perceptohet me ndjenjën e përvetësimit të saj aktiv nga njeriu në socializëm në peizazhet ku ndryshojnë nuancat delikate të dritës nga vendet ku ndërtohet hidrocentrali «Në Fierzë» prej Kujtim Buzës, në «Peizazhin e fshatit» të Arben Bashës, ku penelatat pastoze shprehin begatinë e gjelberimit të larmishëm, në peizazhin detar të mbështjellë nga një dritë sugjesteive «Në bazë» të Avénir Sadikaj etj.

Në institucionet kulturore e shoqërore, në muzetë, në galeritë e artit që janë ngritur në shumë qytete të Shqipërisë, në ekspositat kombëtare e të tjera, që hapen njëra pas tjetës, veprat e piktures, ashtu si gjithë arti shqiptar me përbajtje socialiste, me karakter militant, me frymë popullore e fisionomi kombëtare, gjëojnë estetikisht masat e gjera të popullit me bukurinë e tyre, i frymëzojnë me dashurinë për punën, socializmin dhe atdheun, i ushqejnë me virtute të larta morale e shoqërore proletare, me idealet komuniste.

Piktura shqiptare kërkon të jetë e përkryer dhe për këtë qëllim artistët shqiptarë të realizmit socialist kanë gjithnjë parasysh se «Arti i vërtetë forcon tiparet e veta novatore dhe fiton një nivel të lartë artistik, — siç tha shoku Enver Hoxha në Kongresin VII të PPSH, — kur mishëron një përbajtje revolucionare dhe kur udhëhiqet nga idealet komuniste». Prej këtej rrjedh përfundimi se baza e përparimit të arteve të realizmit socialist është partishmëria e tyre proletare.



























13



14














20



21




















30a



30




































45





46

































1957 B. Sejdini









Sophie V. Ettinger















A. Fomin

71

























François Flameng



















92



93









97



98



99



100





















































124



126a




125






















135



136



































































GP NV 1976

















173



174






















183


















189



190

















Rokip Šukabatić





















P. KOKAN







210



211





RRUGA
KONFERENCA
E PEZES











PËRMBAJTJA

1. ENVER HOXHA (pikturë nga Z. Shoshi)

Kol Idromeno (1860-1929)

2. — Motra Tome
Galeria e Aritë Tirane, vaj, 75 x 60 cm., 1883.
3. — Malesori
Galeria e Aritë Tirane, vaj, 25 x 33 cm., 1890.
4. — Portret i Plakut
Galeria e Aritë Tirane, vaj, 64 x 77 cm., 1920.
5. — Oborri i Shtëpisë Shkodrane
Galeria e Aritë Tirane, vaj, 38 x 49,5 cm. (rreth 1920)
6. — Dasma Shkodrane
Galeria e Aritë Tirane, vaj, 133 x 94 cm., 1924

Spiro Xega (1863-1953)

7. — Skënderbeu
Galeria e Aritë Tirane, vaj, 77,5 x 107 cm.
8. — Çeta e Shahin Matrakut
Galeria e Aritë Tirane, vaj, 108 x 130 cm.

Ndoci Martini (1800-1917)

9. — Portret
Galeria e Aritë Tirane, vaj, 46 x 52 cm.

Andrea Kushi (1885-1959)

10. — Vajza me kostum
Galeria e Aritë Tirane, vaj, 32 x 39 cm. (rreth 1930)
11. — Portret bariu
Galeria e Aritë Tirane, vaj, 55 x 75 cm., 1933

Simon Rrota (1887-1961)

12. — Beteja e Skënderbeut
Galeria e Aritë Shkodrë, vaj, 58 x 104 cm., 1923
13. — Portet në Shkodër
Galeria e Aritë Tirane, vaj, 32 x 48 cm. (rreth 1930)
14. — Pregatitja e drekës
Familja e autorit, vaj, 80 x 102 cm., 1943.
15. — Te pusi i fshatit
Galeria e Aritë Tirane, vaj, 60 x 85,5 cm.

Vangjush Mio (1891-1957)

- Piktor i popullit
16. — Ligeni i Pogradecit në ditë shiu
Galeria e Aritë Tirane, vaj, 55 x 66 cm.
 17. — Tirana e viti 1939
Galeria e Aritë Tirane, vaj, 70 x 76cm., 1939.
 18. — Rrugë në Korgë
Galeria e Aritë Tirane, vaj, 67 x 77 cm., 1940.
 19. — Dilmëri në Korgë
Galeria e Aritë Tirane, vaj, 51 x 65 cm., 1943.
 20. — Tuneli i Rrogozhinës

Galeria e Aritë Korgë, vaj, 64 x 76 cm., 1947.

21. — Traktorët në fushë
Galeria e Aritë Korgë, vaj, 66 x 76 cm., 1951.
22. — Vjeshtë (Manat e Drenovës)
Selia e Kuvendit Popullor të RPSSH, vaj, 59 x 47 cm., 1953.
23. — Malet e Moravës
Galeria e Aritë Tirane, vaj, 53 x 66 cm.
24. — Manat e Drenovës
Galeria e Aritë Tirane, vaj, 57 x 67 cm., 1955.
25. — Vjetja e paxhaxit
Galeria e Aritë Tirane, vaj, 80 x 98 cm.
26. — Vjeshtë në Drenovë
Galeria e Aritë Tirane, vaj, 48 x 63 cm.

Abdurahim Buza (1905)

Piktor dhe mësues i merituar i RPSSH

27. — Kokë djall, fragment
Galeria e Aritë Tirane, vaj, 25 x 30 cm., 1934.
28. — Punë vullnetare në kombinatin e tekstileve «Stalino»
Galeria e Aritë Tirane, vaj, 48 x 66 cm., 1948.
29. — Dilmëri në Tirane
Studio e autorit, Tirane, vaj, 35 x 54 cm., 1957.
30. — Refugjatët
Galeria e Aritë Tirane, vaj, 41 x 50 cm., 1957.
- 30a. — Refugjatët (detali)
31. — Nusja kosovare
Galeria e Aritë Tirane, vaj, 36 x 48 cm., 1962.
32. — Shqipëria vallzon,
Galeria e Aritë Tirane, vaj, 70 x 73 cm., 1971.
33. — Lojra populllore
Galeria e Aritë Tirane, vaj, 105 x 124,5, 1974.
34. — Azem Galicë me trimit qan rrëthimlin
Galeria e Aritë Tirane, vaj, 48 x 58 cm., 1976.
35. — Barrkada në Tirane
Galeria e Aritë Tirane, vaj, 55 x 80 cm., 1976.

Zef Kolombi (1907-1949)

Piktor dhe mësues i merituar i RPSSH

36. — Tri rriska shalqini
Galeria e Aritë Tirane, vaj, 26 x 30 cm., 1940.
37. — Rrush e dardhë
Galeria e Aritë Tirane, vaj, 44,5 x 59 cm., 1940.
38. — Të korrurat
Galeria e Aritë Tirane, 75 x 100 cm., 1940.
39. — Djall në kopsht
Galeria e Aritë Tirane, vaj, 36 x 46 cm., 1941.
40. — Gryka e lugjeve
Galeria e Aritë Tirane, vaj, 36 x 46 cm., 1948.

Androniqi Antoniu (1913)

41. — Sali Vata

Galeria e Artit Tiranë, vaj, 31 x 40,5 cm., 1951.
42. — Petrela
Galeria e Artit Tiranë, vaj, 63 x 80 cm., 1962.

Jordan Misja (1914-1942)

43. — Natyrë e qetë
Galeria e Artit Tiranë, vaj, 44,5 x 58 cm.

Hasan Reçi (1914)

44. — Pravvera
Galeria e Artit Tiranë, vaj, 51 x 65,5 cm.

Nexhmedin Zajmi (1916)

Piktori i merituar i RPSSH.

45. — Brendi në Theth
Galeria e Artit Tiranë, vaj, 36,5 x 45,5 cm., 1945.

46. — Maltosja
Galeria e Artit Tiranë, vaj, 29,5 x 40 cm., 1947.

47. — Maltosorl
Galeria e Artit Tiranë, vaj, 49,5 x 69 cm.

48. — Tregim nga Lufta Nacionale gjatërritare
Galeria e Artit Tiranë, vaj, 132,5 x 207 cm., 1954.

49. — Nëna Lahe
Galeria e Artit Tiranë, vaj, 38,5 x 49 cm., 1955.

50. — Blegtorja
Galeria e Artit Tiranë, vaj, 49,5 x 70 cm.

51. — Diga e Drimit
Galeria e Artit Tiranë, vaj, 100 x 210 cm., 1969.

52. — Nëndëset
Galeria e Artit Tiranë, vaj, 58 x 69 cm., 1975.

Foto Stamo (1916)

Piktori i Popullit

53. — Pazar i Tiranës
Galeria e Artit Tiranë, vaj, 55,5 x 60 cm., 1941.

54. — Portret gruaje
Galeria e Artit Tiranë, vaj, 33 x 48 cm., 1941.

55. — Partizani, vaj 75 x 120 cm., 1964.

56. — Parecla e pjetshkëve
Galeria e Artit Tiranë, vaj, 45 x 68 cm., 1969.

57. — Dhermu
Galeria e Artit Tiranë, vaj, 50 x 70 cm., 1971.

58. — Gora
Galeria e Artit Tiranë, vaj, 50 x 70 cm., 1974.

59. — Mall i Tomorrit
Galeria e Artit Tiranë, vaj 59,5 x 83,8 cm., 1974.

60. — Kooperativë bujqësore «Misto Mameo»
Galeria e Artit Tiranë, vaj 53,5 x 80 cm., 1975.

Bukurosh Sejdini (1916)

61. — 17 Nëntor 1944
Galeria e Artit Tiranë, vaj, 100 x 127 cm., 1957.

62. — Qemal Stafa
Galeria e Artit Tiranë, vaj, 78 x 109 cm., 1964.

Qamil Grezda (1917)

63. — Të korruarat e grurit
Galeria e Artit Tiranë, vaj, 25,5 x 35 cm., 1943.

64. — Në pyjet e Lurës
Galeria e Artit Tiranë, vaj, 49,5 x 64,5 cm., 1956.

Sofia Papadhimitri (1918-1976)

65. — Portret gruaje
Galeria e Artit Tiranë, vaj, 43 x 52 cm.

66. — Kalaja e Gjirkastrës
Galeria e Artit Tiranë, vaj, 49 x 59,5 cm., 1957.

Kel Kodheli (1920)

67. — Shqiponjat partizane
Galeria e Artit Tiranë, vaj, 130 x 160,5 cm., 1957.

68. — Korjerja e Heronje të Vlugut
Galeria e Artit Tiranë, vaj, 70,5 x 100 cm., 1966.

69. — Çergj Topulli
Galeria e Artit Tiranë, vaj, 68,5 x 87,7 cm., 1974.

70. — Ura e Bushtricës
Galeria e Artit Tiranë, vaj, 49,5 x 65 cm., 1974.

Abdulla Cangonji (1920)

71. — Pelsazh vjeshtë
Galeria e Artit Tiranë, vaj, 48 x 63 cm., 1957.

72. — Peshkatarët
Galeria e Artit Tiranë, vaj, 133 x 200,5 cm., 1964.

73. — Brigada e Flerzës
Galeria e Artit Tiranë, vaj, 48 x 52 cm., 1974.

Guri Madhi (1921)

Piktori i Popullit

74. — Portret i Inësës
Galeria e Artit Tiranë, vaj, 49 x 65 cm., 1952.

75. — Në shpellën e Dragobëzit
Selia e Komitetit Qendror të PPSH, vaj, 190 x 250 cm., 1956.

76. — Dorëzimi i armëve
Galeria e Artit Tiranë, vaj, 61 x 95 cm., 1957.

77. — Formimi i Shtabit të Përgjithshëm
Shtëpia Qendrore e Ushtorisë Popullore, vaj, 1963.

78. — Ndarija e tapive
Selia e Kuvendit Popullor të RPSSH, vaj, 300 x 500 cm., 1973.

79. — Mbledhja e Moskës
Galeria e Artit Tiranë, vaj, 210 x 265 cm., 1974.

Vladimir Jani (1921)

80. — Natyrë e qetë
Galeria e Artit Tiranë, vaj, 67 x 97 cm., 1957.

Shefqet Agalliu (1922-1946)

81. — **Rruja e Barigadave**
Galeria e Artit Tirane, vaj, 30 x 34 cm.
82. — **Nga dritaria**
Galeria e Artit Tirane, vaj, 36 x 44 cm.

Hysen Devollli (1924)

Piktur i merituar i RPSSH

83. — **Dorëzimi i armëve**
Galeria e Artit Tirane, vaj, 178 x 204 cm., 1967.
84. — **NË kantier**
Galeria e Artit Tirane, vaj, 88,3 x 118 cm., 1975.

Futmir Haxhiu (1928)

85. — **Skrokë 1944**
Galeria e Artit Tirane, vaj, 206 x 230 cm., 1966.
86. — **Në ditët mësimyjës pranverore**
Galeria e Artit Tirane, vaj, 215 x 233 cm., 1968.
87. — **Në tendën e Qypit**
Galeria e Artit Tirane, vaj, 270 x 500 cm., 1968.
88. — **Këshillitarët e Hekalit**
Galeria e Artit Tirane, vaj, 302 x 242,5 cm., 1971.
89. — **Shpalja e Republikës**
Selia e Kuvendit Popullor, vaj, 400 x 600 cm., 1974.

Refail Dembo (1929)

90. — **Kusha e Korgës**
Galeria e Artit Tirane, vaj, 41 x 67 cm., 1964.

Angjelin Dodmasei (1929)

91. — **Pelsazh**
Galeria e Artit Tirane, vaj, 30 x 40 cm., 1967.

Todi Matu (1930)

92. — **Mokër**
Galeria e Artit Korçë, vaj, 45 x 65 cm., 1976.
93. — **Brendi**
Galeria e Artit Tirane, vaj, 60 x 72,5 cm., 1974.

Vilson Halimi (1931)

94. — **Gju më gju me popullin**
Galeria e Artit Tirane, vaj, 170 x 217 cm., 1969.
95. — **Shokë luftë shokë jetë**
Galeria e Artit Tirane, vaj, 139 x 202,5 cm., 1974.
96. — **Kudo jemi në ballë**
Galeria e Artit Tirane, vaj, 165 x 145 cm., 1976.

Hiqmet Agolli (1932)

97. — **Tekstilitja**
Në shtëpinë e Rinisë, vaj, 90 x 130 cm.

98. — **Oxhaqet pushtuan qellin**

Galeria e Artit Tirane, vaj, 75 x 100 cm.

Vilson Kilicu (1932)

Piktur i merituar i RPSSH

99. — **Pelsazh Industrial**
Galeria e Artit Tirane, vaj, 61 x 96 cm., 1967.
100. — **Dhjetor 1967**
Galeria e Artit Tirane, vaj, 106 x 221 cm., 1968.
101. — **Punturët**
Shkolla e Partisë V.I. Lenin, vaj, 215 x 300 cm., 1969.
102. — **Demonstratët e Varshevës**
Galeria e Artit Tirane, vaj, 257 x 317 cm., 1974.
103. — **Midis popullit ushtar**
Muzeumi i M.B. Brendëshme, vaj, 100 x 125 cm., 1975.
104. — **Shoku Enver Hoxha**
Galeria e Artit Tirane, vaj, 116 x 130 cm., 1976.

Ksenofon Dilo (1932)

Piktur i merituar i RPSSH

105. — **Pushka top**
Galeria e Artit Tirane, vaj, 198 x 232 cm., 1974.
106. — **I gjithë popullit kuftar**
Galeria e Artit Tirane, vaj, 66 x 98,5 cm., 1975.

Sali Shijaku (1933)

Piktur i merituar i RPSSH

107. — **Artilleria e Skënderbeut**
Galeria e Artit Tirane, vaj, 151 x 220 cm., 1968.
108. — **Vojo Kushl**
Galeria e Artit Tirane, vaj, 200 x 300 cm., 1969.
109. — **Pelsazh fshat**
Galeria e Artit Tirane, vaj, 59 x 70 cm., 1972.
110. — **Nënat**
Galeria e Artit Tirane, vaj, 130 x 151 cm., 1973.
111. — **Zëri i mësës**
Galeria e Artit Tirane, vaj, 206 x 252 cm., 1974.
112. — **Fshatku kuftar**
Galeria e Artit Tirane, vaj, 50 x 70 cm., 1974.
113. — **Mle Sokoll**
Galeria e Artit Tirane, vaj, 130 x 130 cm., 1976.
114. — **Pranvera**
Galeria e Artit Tirane, vaj, 50 x 70 cm., 1975.

Ismail Lulani (1933)

115. — **Qerime Shën Gjelë**
Galeria e Artit Tirane, vaj, 65 x 94 cm., 1974.
116. — **Pelsazh**
Galeria e Artit Tirane, vaj, 56 x 76 cm., 1974.
117. — **Në malezi**
Galeria e Artit Tirane, vaj, 70 x 119,5 cm., 1974.

118. — 29 Nëntor 1944
Galeria e Arit Tirana, vaj, 140 x 160 cm., 1976.
- Jakup Keraj (1934)**
119. — Kuvendi i Lezhës
Muzeu Historik Krujë, vaj, 1968.
120. — Portret i piktorit
Galeria e Arit Tirana, vaj, 66 x 67 cm., 1959.
- Danish Juknui (1934)**
121. — Partizan
Galeria e Arit Tirana, vaj, 99 x 138 cm., 1966.
122. — Në kanderin e drithës
Galeria e Arit Tirana, vaj, 195 x 195 cm., 1969.
123. — Barqit në bjeshtë
Galeria e Arit Tirana, vaj, 165 x 208 cm., 1974.
- Hasan Nallbani (1935)**
124. — Tekstilitja
Galeria e Arit Tirana, vaj, 86 x 114 cm., 1966.
125. — Aksionisti
Galeria e Arit Tirana, vaj, 1966.
126. — Urdhër nga shtati
Galeria e Arit Tirana, vaj, 120 x 220 cm., 1969.
- 126a. — Urdhër nga shtati (detali)
127. — Ceta e Laoe Backës
Galeria e Arit Tirana, vaj, 125 x 127 cm., 1976.
- Isuf Sulovari (1935)**
128. — Kooperativtja e duhanit
Galeria e Arit Tirana, vaj, 60,5 x 74 cm., 1969.
129. — Pushmi partizan
Galeria e Arit Tirana, vaj, 128 x 225 cm., 1971.
- Mineila Saro (1935)**
130. — Një për të gjithë, të gjithë për një
Galeria e Arit Tirana, vaj, 207 x 248 cm., 1968.
131. — Buria & fitores
Shëpia e kulturës Pier, vaj, 240 x 240 cm., 1971.
- Andon Lukuriqi (1935)**
132. — Fundi i fashistëve
Galeria e Arit Tirana, vaj, 194 x 200 cm., 1966.
133. — Atyre që i kënduan luftës
Galeria e Arit Tirana, vaj, 220 x 189 cm., 1974.
134. — Kthim nga puna
Galeria e Arit Tirana, vaj, 170 x 187 cm., 1976.
- Xhemal Lufta (1935)**
135. — Kooperativa e Arzës
- Galeria e Arit Tirana, vaj, 22 x 32 cm., 1974.
136. — Bregdeti
Galeria e Arit Tirana, vaj, 28 x 38 cm., 1974.
- Niko Progri (1936)**
137. — Lajmet e mëngjesit
Galeria e Arit Tirana, vaj, 102 x 132 cm., 1976.
- Agim Zajmi (1936)**
- Piktor i merituar i RPSSH
138. — Dritë në malet tonë
Galeria e Arit Tirana, vaj, 65 x 95 cm., 1969.
139. — Në akson
Galeria e Arit Tirana, vaj, 140 x 190 cm., 1974.
140. — Vasil Laçl
Galeria e Arit Tirana, vaj, 81 x 100 cm., 1974.
141. — Vje të pushuar
Galeria e Arit Tirana, vaj, 130 x 180 cm., 1976.
142. — Buqësia çështje e gjithë popullit
Galeria e Arit Tirana, vaj, 75 x 90 cm., 1976.
- Dhimitoraq Trebicka (1938)**
143. — Kthim nga aksioni
Galeria e Arit Tirana, vaj, 240 x 300 cm., 1969.
144. — Në këshijellën e Krujës
Galeria e Arit Tirana, vaj, 70 x 79,5 cm., 1976.
145. — Pas qytetit
Galeria e Arit Tirana, vaj, 150 x 152,5 cm., 1973.
146. — Blij të tokës
Galeria e Arit Tirana, vaj, 150 x 180 cm., 1976.
- Spiro Kristo (1936)**
147. — Fëmijët
Galeria e Arit Tirana, vaj, 193 x 205 cm., 1966.
148. — Dritë fluturimi
Galeria e Arit Tirana, vaj, 187 x 211 cm., 1968.
149. — Shoxa Enver Hoxha gjatë luftës Nacionalelirësme
Muzeu i Min.P.Brendshme, vaj, 135 x 145 cm., 1974.
150. — Montatori
Galeria e Arit Tirana, vaj, 122 x 95 cm., 1976.
151. — Brigadlerja
Galeria e Arit Tirana, vaj, 110 x 95 cm., 1976.
- Harilla Dhima (1936)**
152. — 7 Prilli 1939
Galeria e Arit Tirana, vaj, 121,5 x 129,5 cm., 1974.
- Sotir Capo (1936)**
153. — Shkolla partizane
Shkolla e Partisë V.I.Lenin, vaj, 200 x 220 cm., 1969.

154. — **Puntore e uzinës së telave**
Galeria e Arit Tiranz, vaj, 95 x 120 cm., 1969.
155. — **Mjelësja**
Galeria e Arit Tiranz, vaj, 80 x 115 cm., 1974.
- Kujtim Buza (1937)**
156. — **Tiranë në festë**
Galeria e Arit Tiranz, vaj, 81 x 101 cm., 1974.
157. — **Në kufi**
Galeria e Arit Tiranz, vaj, 60 x 81 cm., 1975.
158. — **Flerzë**
Galeria e Arit Tiranz, vaj, 90 x 100 cm., 1975.
159. — **Flerzë, veprë e marrjes**
Galeria e Arit Tiranz, vaj, 76 x 72 cm., 1976.
- Pjerin Sheldija (1937)**
160. — **Greva e punëtorëve të fabrikës së qlementos e vitit 1940**
Këshilli Qendor i B. Profesionale, vaj, 110 x 150 cm., 1974.
- Sotiraq Sholla (1937)**
161. — **Do të lutojmë për një botë të re**
Galeria e Arit Korçë, vaj, 170 x 180 cm., 1976.
- Lee Shkreli (1938)**
162. — **I pamposhturit Manush Aliman**
Galeria e Arit Tiranz, vaj, 210 x 220 cm., 1969.
163. — **Komuniteti**
Galeria e Arit Tiranz, vaj, 200 x 220 cm., 1971.
164. — **Kombart dhe mësuesi i popullit Qamili Guraniaku**
Galeria e Arit Tiranz, vaj, 145 x 200 cm., 1976.
- Gavril Priftuli (1938)**
165. — **Pranverë në Gjirokastër**
Galeria e Arit Durrës, vaj, 125 x 105 cm., 1976.
- Nikolai Vusia (1945)**
166. — **Çlirim i Durrësit (mozaik)**
Varrezat e Dëshmorëve Durrës, 1975.
- Shaban Hysa (1938)**
167. — **Më tej**
Galeria e Arit Tiranz, vaj, 195 x 253 cm., 1969.
168. — **U themeliu Partia**
Galeria e Arit Tiranz, vaj, 210 x 230,5 cm., 1974.
169. — **Trakti**
Galeria e Arit Tiranz, vaj, 160 x 152 cm., 1976.
- Fiqiri Progri (1938)**
170. — **Festë në qytet**
171. — **Vajza fshatore**
Galeria e Arit Tiranz, vaj, 61 x 80 cm., 1964.
172. — **Tornitorja**
Galeria e Arit Tiranz, vaj, 74,5 x 120 cm., 1969.
173. — **Vjeljsja e duhanit**
Galeria e Arit Tiranz, vaj, 80,5 x 130 cm., 1971.
174. — **Krijimi i kooperativës malore**
Galeria e Arit Tiranz, vaj, 185 x 221 cm., 1974.
175. — **Gju më gju me popullin**
Galeria e Arit Tiranz, vaj, 190 x 225 cm., 1976.
176. — **Shevqet Musaraj**
Galeria e Arit Tiranz, vaj, 100 x 90 cm., 1976.
- Ferdinand Paci (1939-1975)**
177. — **Nënrat marrin hak**
Galeria e Arit Tiranz, vaj, 230 x 250 cm., 1971.
178. — **Shqipëria në festë**
Galeria e Arit Tiranz, vaj, 208 x 208 cm., 1974.
179. — **Veterani**
Galeria e Arit Tiranz, vaj, 78 x 92 cm., 1974.
- Skënder Kamberi (1939)**
180. — **Betimi i Vrana Kontit**
Galeria e Arit Tiranz, vaj, 140 x 210 cm., 1968.
181. — **Buka e duarve tonë**
Galeria e Arit Tiranz, vaj, 180 x 240 cm., 1976.
- Pandi Mele (1939)**
182. — **Koc Bako**
Galeria e Arit Tiranz, tempera, 75,5 x 272 cm., 1966.
183. — **Ushtarët e revolucionit (triptik)**
Galeria e Arit Tiranz, vaj, 125,5 x 309 cm., 1968.
184. — **Ju flet Tirana, Nëntor 1944**
Galeria e Arit Tiranz, vaj, 105 x 105 cm., 1976.
- Nestor Jonuzi (1939)**
185. — **Gëzimini i flores**
Galeria e Arit Tiranz, vaj, 186 x 226 cm., 1974.
186. — **Lule more trima, Drashoviqë**
Galeria e Arit, Vlorë, vaj, 190 x 270 cm., 1976.
- Jorgji Gjikopulli (1939)**
187. — **Në mëngjjez me detarët**
Galeria e Arit Tiranz, vaj, 55 x 80 cm., 1973.
188. — **Gjaza e parkit**
Galeria e Arit Tiranz, vaj, 140 x 150 cm., 1976.

Agim Faju (1929)

189. — Verë e vittit 1965
Galeria e Arit Tirane, vaj, 100 x 305 cm., 1965.
190. — Gratë e fshatit tonë (pjesh nga polipktiku)
Galeria e Arit Durrës, vaj, 1966.
191. — Në emër të Jetks, (Nënë Zelihaja)
Galeria e Arit Durrës, vaj, 162 x 180 cm., 1974.
192. — Me ballfik tek Ilirja (Gjikë Kasqall)
Galeria e Arit Durrës, vaj, 150 x 100 cm., 1976.

Petrit Ceno (1929)

193. — 28 Nentor, 1912
Selia e Presidiumit të Kuvendit Popullor, vaj, 160 x 240 cm., 1974.

Sabaudin Xhaferri (1939)

194. — Heroina e Popullit Zonja Çurre
Galeria e Arit Tirane, vaj, 163 x 224 cm., 1973.
195. — Ky truall ka zot
Galeria e Arit Tirane, vaj, 150 x 200 cm., 1976.

Liliana Çefaj (1940)

196. — Në muze
Galeria e Arit Tirane, vaj, 133 x 159,5 cm., 1974.
197. — Do të kemi nënë Partinë
Galeria e Arit Shkodër, vaj, 125 x 135 cm., 1976.

Rakip Shahani (1941)

198. — Nëna e dëshmorit
Galeria e Arit Tirane, vaj, 70 x 100 cm., 1974.

Myrteza Fushekati (1942)

199. — Gjenologët e rinj
Galeria e Arit Tirane, vaj, 165 x 210 cm., 1969.
200. — Gjimnastët
Galeria e Arit Tirane, vaj, 157 x 170 cm., 1970.
201. — Para manifestimit
Galeria e Arit Tirane, vaj, 186 x 180 cm., 1974.
202. — Tefta Tashko Koço
Galeria e Arit Tirane, vaj, 100 x 120 cm., 1976.

Agim Shami (1942)

203. — Gjithmonë gati
Galeria e Arit Tirane, vaj, 90 x 111 cm., 1974.

Koleo Nini (1943)

204. — Kallëzat
Galeria e Arit Tirane, vaj, 140 x 120 cm., 1976.
205. — Barinjtë
Galeria e Arit Tirane, vaj, 141 x 185 cm., 1974.

Petro Kokushta (1943)

206. — Shtëpia ku u themelua Partia
Galeria e Arit Tirane, vaj, 106 x 134,5 cm., 1971.
207. — Ndërtimi i hekurudhës së metalurgjisë
Galeria e Arit Tirane, vaj, 50 x 70 cm., 1976.

Musa Qarri (1944)

208. — Shqyqri Kanapari
Galeria e Arit Tirane, vaj, 80,5 x 116 cm., 1974.

Qirjako Meniko (1945)

209. — Mijra përmë aksion
Galeria e Arit Tirane, vaj, 60 x 80 cm., 1968.

Arben Basha (1947)

210. — Pelsazh fshat
Galeria e Arit Tirane, vaj, 56 x 69 cm., 1974.
211. — Pelsazh
Galeria e Arit Tirane, vaj, 70 x 60 cm., 1976.

Avenir Sadikaj (1948)

212. — Në bazë
Galeria e Arit Tirane, vaj, 50 x 70 cm., 1975.

Agron Dine (1949)

213. — Vllet e para
Galeria e Arit Vlorë, vaj, 1974.
214. — Ndryuan kohët
Sësia e Komitetit Ekzekutiv të K.P. mështit Tirane, vaj, 150 x 200 cm., 1976.

Zamir Mati (1951)

215. — Vllet e para
Galeria e Arit Tirane, vaj, 66 x 66 cm., 1975.

Bujur Asllani (1951)

216. — Barinjtë
Galeria e Arit Tirane, vaj, 120 x 120 cm., 1976.

Shpëtim Arapi (1949)

217. — Drejt lartësive
Galeria e Arit Tirane, vaj, 130 x 180 cm., 1976.

Nikolin Ivanaj (1949)

218. — Askujt nuk i dorëzohem
Galeria e Arit Tirane, vaj, 140 x 140 cm., 1976.

Pregatitur nga Galeria e Arteve Figurative

